

VENDIM
Nr. 4, datë 29.4.2022

**PËR MIRATIMIN E MARZHEVE NË BAZË TË MONITORIMIT TË ÇMIMEVE
PËR PRODUKTET USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTET E TJERA TË LIDHURA
ME TO, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG**

Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, në zbatim të aktit normativ nr. 7, datë 18.3.2022, “Për transparencën dhe monitorimin e çmimit për disa produkte ushqimore bazë dhe produkte të tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg”,

VENDOSI:

1. Miratimin e marzheve që do të aplikohen për disa produkte ushqimore bazë, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar nga rritja e çmimeve ndërkombëtare.

2. Për artikullin oriz kokërrgjatë (1 kg) miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të orizit kokërrgjatë 11.7% mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerë 11 lekë/kg. Ky marzh mbulon edhe shpenzimet e ambalazhimit brenda vendit;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të orizit kokërrgjatë 3.8% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerë 4 lekë/kg.

3. Për artikullin sheqer (1 kg) miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të sheqerit nga importuesi dhe ambalazhuesi 11.1% (3.8 % + 7.3%) mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerë 12 lekë/kg;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të sheqerit 3.4% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerë 4 lekë/kg.

4. Për artikullin vaj luledielli miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë nga importuesit të vajit të ambalazhuar të lulediellit 10.3% mbi koston e importit dhe detyrimet e paguara në doganë, ose në vlerë 35 lekë/litër. Ky marzh mbulon edhe shpenzimet e inbotimit dhe ambalazhimit;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të vajit të ambalazhuar të lulediellit 1.6% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerë 6 lekë/litër.

5. Për artikullin miell masiv miratohen marzhet si më poshtë:

a) marzhi i tregtimit të shitjes me shumicë të miellit nga prodhuesi dhe ambalazhuesi 33.9% e koston së grurit të importuar, ose 19 lekë/kg. Ky marzh mbulon edhe kostot e përpunimit të grurit, prodhimin e miellit dhe ambalazhimin e tij;

b) marzhi i tregtimit të shitjes me pakicë të miellit 5.3% mbi çmimin e shitjes me shumicë, ose në vlerë 4 lekë/kg.

6. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha subjektet që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet e përcaktuara në këtë vendim.

7. Në pasqyrën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, jepen të dhënat në lidhje me përlllogaritjet e çmimit të tregtimit sipas marzheve të përcaktuara në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi në datën 30.4.2022 dhe i shtrín efektet deri në mbledhjen e ardhshme të Bordit. Ky vendim do të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për bujqësinë.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Frida Krifca, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Nikolla Lera, Vjollca Ferra, Gentian Celo, Ermal Babameto, Irfan Tarelli, Jeta Deda, Fuad Haxhiymeri, Elona Hametaj Mema, Majlinda Bajraktari

PASQYRA NR. 1

Përshkrimi	Kostoja në import dhe pagesa në doganë	Marzhi në import/shumicë		Marzhi me shumicë (importuesi i ndryshëm nga shitësi me shumicë)		Marzhi me pakicë		Çmimi i shitjes me pakicë	Sqarime
		%	vlerë	%	vlerë	%	vlerë		
Oriz kokërrgjatë	94 lekë/kg	11.7%	11 lekë/kg			3.8%	4 lekë/kg	109 lekë/kg	Për shkak të varieteteve të ndryshme të orizit të importuar në thasë, baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë të produktit është kosto më e ulët e zhdoganimit të produktit oriz ndërmjet datave 12–27 prill 2022, në nivel subjekti. Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar. Në rastet kur ndërmjet shitësit me shumicë dhe shitësit me pakicë operon një hallkë ndërmjetëse, marzhi i llogaritur 3.8% (4 lekë/kg) ndahet ndërmjet tyre.
Sheqer	105 lekë/kg	3.8%	4 lekë/kg	7.3%	8 lekë/kg	3.4%	4 lekë/kg	121 lekë/kg	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 12–27 prill 2022, ku për bazë janë marrë 97% e zhdoganimeve të sheqerit të papaketuar. Marzhi i shumicës mbulon kostot e ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar.
Vaj luledielli	340 lekë/litër	10.3%	35 lekë/litër			1.6%	6 lekë/litër	381 lekë/litër	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 12–27 mars 2022, ku për bazë janë marrë (3 subjektet me peshën më të lartë të zhdoganimeve). Marzhi i shumicës mbulon kostot e inbotilimit, ambalazhimit, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar.
Miell	56 lekë/kg	33.9%	19 lekë/kg			5.3%	4 lekë/kg	79 lekë/kg	Baza e përdorur për llogaritjen e çmimit me shumicë është kostoja mesatare e ponderuar e zhdoganimeve gjatë datave 12–27 mars 2022, ku për bazë janë marrë 98% e zhdoganimeve të grurit. Marzhi i shumicës mbulon kostot e përpunimit të grurit dhe prodhimit të miellit, ambalazhimit, firot ligjore, si dhe çdo kosto biznesi, përfshirë shpenzimet operationale dhe çdo shpenzim tjetër për tregtimin e produktit të paketuar.